



# Plani Strategjik i AKK-së 2016-2020



**Në shërbim të komunave për të avancuar demokracinë  
lokale dhe cilësinë e jetesës për qytetarët e tyre**



Prishtinë, 2015

---



## 1. Historiku dhe qëllimi

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) është organizatë joprotabile e regjistruar sipas ligjit dhe e themeluar për t'i përfaqësuar dhe për t'u shërbyer interesave të anëtarëve të saj, gjegjësisht komunave të Kosovës.

AKK-ja është themeluar më 26 janar 2001, pas mbajtjes së suksesshme të zgjedhjeve të para demokratike komunale në Kosovë, duke u bazuar në nenin 10 të Kartës Evropiane për Autonominë Lokale, respektivisht në të drejtën për asociim.

Plani Strategjik i AKK-së për periudhën nga viti 2016 deri në vitin 2020 bazohet në Startegjinë paraprake për periudhën 2011-2015, i cili është përpunuar edhe nga sfidat që kanë dalë gjatë zbatimit të Strategjisë së kaluar si dhe duke i'u është përshtatur zhvillimeve të kohës së fundit.

Prandaj, ky plan i ofron AKK-së një kornizë për strategjinë afatmesme si dhe udhëzime operative për programet vjetore të saj. Poashtu do të shërben për ta lehtësuar komunikimin dhe bashkërendimin me partnerët kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar me AKK-në.

Vendimi për ta hartuar Planin Strategjik 2016-2020 është marrë nga Bordi i AKK-së, i cili do të ketë zbatohet pesë vitet e ardhshme. Bordi ka vendosur që (1) t'i përshtatet kontekstit të ndryshuar që nga viti 2011, (2) t'i vlerësojë përparësitë dhe mangësitë aktuale të organizatës dhe të nxjerrë përfundime të duhura, bazuar edhe në procesin e aktiviteteve të katërvjeçarit të fundit, dhe (3) t'i identifikojë mundësitë për të ardhmen afatmesme.

Periudha pesëvjeçare që mbulohet nga ky Plan Strategjik është thelbësore për vazhdimin e përforcimin institucional, organizativ dhe financiar të AKK-së.

## 2. Organet dhe funksionet e AKK-së

Organizimi i AKK-së konsiston në tri nivele kryesore, të cilat ndërlidhen me (1) qeverisjen, (2) funksionet profesionale, dhe (3) funksionet operative.

### Organet e qeverisjes

**Kuvendi i Përgjithshëm** është organi më i lartë qeverisës i AKK-së. Kuvendi ka 126 anëtarë dhe përbëhet nga të gjithë kryetarët e komunave dhe nga një këshilltar i zgjedhur për secilin nga dhjetë këshilltarët komunalë dhe përfaqësues nga komunitetet jo-shumicë në Kuvendet e Komunave. Kuvendi i Përgjithshëm e zgjedh **Kryetarin e AKK-së, Zëvendëskryetarin** dhe pesë anëtarët e **Bordit të AKK-së (gjithsej 7 anëtar të Bordit)**, nga radhët e **Këshillit të Kryetarëve të Komunave**.

### Kolegjiomet profesionale

Kolegjiomet aktualisht merren me çështjet si vijon: (i) ekonomi dhe zhvillimin, (ii) shërbimet publike, (iii) administratën (iv) financat, (v) çështjet ligjore, (vi) planifikimin hapësinor (vii) shëndetin dhe mirëqenien sociale, (viii) arsimin, (ix) teknologjinë informative, (x) kryesuesit e Kuvendeve të Komunave, (xi) integrimin evropian dhe (xii) inspektorët komunalë.

### Administrata

Menaxhimi i çështjeve të përditshme të AKK-së i delegohet zyrës së saj ekzekutive e udhëhequr nga drejtori ekzekutiv. Stafi përbëhet nga katër menaxher të sektorëve të cilët ndihmohen nga gjashtë punonjësit mbështetës të administratës.

## 3. Analiza e situatës

### 3.1. Zhvillimet kontekstuale kryesore

Bartja e përgjegjësi nga niveli qendror në atë lokal nuk ka përfunduar ende. Miratimi i ligjeve të reja që prekin kompetencat e komunave në Kosovës është duke vazhduar edhe më tutje. Në përgjithësi, legjislacioni bazë sa i përket funksionimit të pushtetit lokal në Kosovë është definuar deri në një masë të madhe mirëpo, legjislacioni sekondar e që prek kompetencat e nivelit lokal është në zhvillim e sipër dhe proceset janë dinamike. Edhe në vitet në vijim AKK do të koncentrohet në proceset e lobimit dhe avokimit sa i përket ligjeve, strategjive, akteve nënligjore si dhe udhëzimeve administrative që do i prekin kompetencat e pushtetit lokal në Kosovë. Kjo do të siguroj që relevanca dhe rëndësia e AKK-së si organizate unike dhe e cila është në pronësi të komunave, është e pakontestueshme, ajo do të luaj rolin qenësor të lobuesit dhe avokuesit që të siguroj që interesave të komunave t'u kushtohet kujdes i duhur në nivel të qeverisë qendrore.

Me marrëveshjen e Gushtit të vitit 2015 në mes Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Serbisë dhe më ndërmjetësimin e Komisionit Evropian, Kosova do të ketë edhe një Asociacion të Komunave me shumicë serbe. AKK do të jetë e përkushtuar që të bashkëpunojë me çdo organizatë e cila do të mbrojë interesat e autoriteteve lokale në Kosovë. Anëtarësia në AKK mbetet e hapur për të gjitha komunat e Kosovës.

Gjatë periudhës në vijim pritet që Kosova të anëtarsohet në Këshillin e Evropës në Strasbourg dhe me këtë pritet që edhe AKK të ndryshojë statusin e saj nga të qenurit vëzhgues në atë të anëtarit me të drejta të plota në Kongresin e Pushtetit lokal të Këshillit të Evropës në Strasbourg. Kjo lëvizje do të ketë ndikim të madh për AKK-në dhe pushtetin lokal në Kosovë sepse pritet që pas këtij veprimi Kosova ta ratifikojë Kartën Evropiane mbi Pushtet Lokal dhe me këtë të bëhet edhe analiza e detajuar se sa legjislacioni në Kosovë është konform Kartës Evropiane për Pushtet Lokal. Kjo do të ishte një vlerë e shtuar për AKK-në si përfaqësuese e komunave në Kosovë që në vitet në vijim të kërkojë që legjislacioni në fuqi në Kosovë t'i përshtatet Kartës Evropiane për Pushtet Lokal dhe që në këtë mënyrë komunat e Kosovës do të jenë shumë më afër realizimit të autonomisë lokale dhe financiere bazuar në këtë kartë. Për më tepër, përparimi i mëtejshëm në procesin e shtetndërtimit do ta shtojë nevojën që komunat t'u ofrojnë shërbime më të mira qytetarëve të tyre. Për këtë qëllim, do të jetë e domosdoshme që, në njërin anë, të zbatohen parimet themelore të qeverisjes lokale bazuar në Kartën Evropiane për Pushtet Lokal, dhe që, në anën tjetër, të krijohet një menaxhment profesional i aftë që ta administrojë komunën në mënyrë të efektshme dhe efektive.

Kosova ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit (MSA) me Bashkimin Evropian, duke shënuar kështu edhe hapin e parë të vendosjes së marrëdhënieve kontraktuale me BE-në. MSA i hap mundësi Kosovës drejt reformimit, përshtatjes dhe implementimit të reformave në të gjithë sektorët përfshirë administratën shtetërore në përgjithësi e në veçanti reformën e administratës lokale ku edhe AKK do të ketë një rol shumë domethënës. AKK së bashku me komunat e Kosovës do të punojë që në nivelin lokal të forcohet demokracia lokale, të ngritet llogaridhënia dhe transparenca ndaj qytetarëve. MSA hap rrugën e

perspektivës ekonomike në përgjithësi dhe perspektivën e zhvillimit Ekonomik Lokal në veçanti. Besohet që në periudhën në vijim Kosova do të përfitojë edhe liberalizimin e vizave që do të ketë një rol domethënës në zhvillimin ekonomik lokal dhe zbutjen e papunësisë. Është normale që krahas fondeve të donatorëve tjerë, fondet nga Komisioni Evropian do të jenë thelbësore dhe ku besohet që komunat në Kosovë më së shumti (përveç granteve dhe donacioneve tjera) do të përfitojnë nga projektet që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik rajonal (ku shpresohet që situata rreth Agjencioneve Zhvillimore Rajonale do të qartësohet dhe do të përfundohet).

Edhe në të ardhmen komunave në Kosovë do t'iu nevojitet që të hartojnë plane të mëtejme strategjike dhe operative dhe që të kenë personel me kualifikim të mjaftueshëm për t'i menaxhuar departamentet teknike dhe administratën e financave, për t'i zotëruar me kompetencë ciklet e projekteve dhe për të qenë të aftë të përfitojnë nga financimi nga palët e treta.

Objektivi kryesor i AKK-së është që edhe në të ardhmen t'u ndihmojë komunave në ndërtimin e kapaciteteve të nevojshme (përmes kolegjiutëve profesionale dhe forumeve tjera brenda AKK-së) për ta përmirësuar performancën e tyre dhe për të lobuar për interesat e tyre në këtë mjedis dinamik.

### **3.2. Analiza SWOT e AKK-së**

Procesi i hartimit të Strategjisë së AKK-së për vitin 2016-2020 është bazuar në qasjen “poshtë-lartë” e cila nënkupton një koncept shumëpërfshirës në hartimin e kësaj strategjie. Si rezultat, hartimi i kësaj strategjie ka kaluar në disa faza. Në fazën e parë është organizuar një punëtori me stafin e AKK-së (administrata) ku është bërë një analizë e strategjisë ekzistuese dhe është shqyrtuar nevoja për futjen e elementëve shtesë në strategjinë e re e cila reflekton punën e AKK-së në 5 vitet e ardhshme. Bordi i AKK-së ka krijuar një komision të veçantë i përbërë nga tre kryetar të komunave dhe të cilët kanë ndihmuar në hartimin e kornizës së strategjisë së AKK 2016-2020. Procesi i hartimit të strategjisë ka vazhduar me përfshirjen e mekanizmave tjerë të AKK-së, si: dërgimi i një pyetësori të të gjithë anëtarët e AKK-së, procesi ka vazhduar me diskutimet me Kolegjiutet profesionale të AKK-së, Këshilli i Kryetarëve, Bordi i AKK-së si dhe miqtë e AKK-së nga komuniteti i donatorëve dhe organizatave ndërkombëtare, partnere të AKK-së. Ky proces, përkatësisht kjo qasje ka bërë të mundur një skanim të gjendjes aktuale dhe parapërgatitjeve për të ardhmen duke u bazuar në analizën SWOT e cila ka pasur në fokus trajtimin e përparësive dhe të dobësive aktuale të AKK-së, por edhe mundësive dhe rreziqeve në të ardhmen. Analizën SËOT të paraqitur në mënyrë skematike e gjeni më poshtë.

## SWOT ANALIZA

Përparësitë	Mundësitë
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pozicionimi i AKK-së është përfundimtar në emër të komunave</li> <li>• Kapacitete të fuqishme lobuese/avokuese</li> <li>• Uniteti i kryetarëve/ përkushtimi dhe angazhimi ndaj decentralizimit të pushtetit.</li> <li>• AKK-ja është organizmi kyç: ka legjitimitet / shtrirje dhe mbulueshmëri/ besim</li> <li>• Përfshirja: Kryetarët, drejtorët, zyrtarët dhe kuvendarët, pra përfshirje e plotë e anëtarëve përmes kolegjiuemeve.</li> <li>• Faktor i besuar i komunave vizavi Qeverisë Qendrore</li> <li>• Partneriteti i mirë me donatorët, KiE-në, NALAS-in, etj.</li> <li>• Besim dhe Imazh i mirë publik / personel i mjaftueshëm</li> <li>• Perceptimi për AKK-në si mbrojtës i interesave të komunave.</li> <li>• Funksional, inovativ dhe fleksibil.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kompetencat e reja të komunave</li> <li>• Roli i AKK në sferën e ngritjes së kapaciteteve për nivelin lokal është i njohur nga qeveria dhe akterët tjerë.</li> <li>• Ish-kryetarët në Parlament dhe Qeveri</li> <li>• Ngritja e sensit te kryetarët që shërbimet duhet të opfrohën për qytetarin e jo për partinë politike.</li> <li>• Rol aktiv në komisionin e granteve</li> <li>• Roli i kolegjiuemeve i njohur dhe i pranuar nga Qeveria</li> <li>• Thithja e fondeve nga BE</li> <li>• Pakot e standardizuara për trajnim</li> <li>• Shërbimet e ofruara nga AKK me pagesë</li> <li>• Futja e pagesës së anëtarësisë në planifikimin buxhetor të komunave</li> <li>• Qeverisja elektronike</li> <li>• Rrjetet sociale /ëebpage</li> <li>• Fuqizimi në rrjetet evropiane (Komiteti i Rajoneve, BE-MSA).</li> <li>• Komuna të fuqishme ekonomike</li> <li>• Bashkëpunimi ndërkomunal në rritje (IMC, CNC)</li> <li>• Rinia dhe studentet si potencial.</li> <li>• Qëllimet për Zhvillim të Qëndrueshëm nga Kombet e Bashkuara</li> </ul>
Dobësitë	Rreziqet
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fondet e pamjaftueshme/varësia nga donatorët</li> <li>• Në disa raste jo të gjithë kryetarë vazhdojnë të mbajnë qëndrimin zyrtar të AKK</li> <li>• Ekspertizë jo e mjaftueshme në sekretariat dhe kolegjiueme.</li> <li>• Anëtarët e Kuvendeve Komunale jo shumë të involvuar në AKK</li> <li>• Mungesë e qasjes sistematike në ndërtimin e skemës për ofrimin e trajnimeve</li> <li>• Mungesa e ekspertizës së brendshme rreth</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mospërfshirja e qeverisjes lokale në kapitull të veçantë të Aquis.</li> <li>• Interesat shtetërore më të rëndësishme se interesat e komunave dhe të AKK.</li> <li>• Tendencë e qeverisë me dobësuar rolin e AKK-së</li> <li>• Fondet e pamjaftueshme për kompetencat e reja</li> <li>• Asociacionet tjera mund të mbajnë qëndrime tjera në lidhje me kompetencat komunale të cilat mund të dobësojnë zërin e komunave.</li> </ul>

<p>financave lokale</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Çështja e kualitetit të kolegjiuemeve për shkak që drejtorët janë të emëruar politik</li> <li>• Zëri i komunave të vogla nuk është dëgjuar sa duhet.</li> <li>• Storit e suksesit jo mjaft të dukshme</li> <li>• Mungesa e ekspertizës së brendshme për fondet e BE dhe decentralizimin financiar.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Jo të gjitha komunat me shumicë serbe të popullatës në Kosovë janë anëtar të AKK-së</li> <li>• Perceptimi për AKK si organizatë vetëm e kryetarëve.</li> <li>• Zhvendosja e ndihmës dypalëshe për fondet e BE</li> <li>• Në disa raste mbivendosje e mandatit me MAPL, MAP , IKAP</li> <li>• Buxheti i Kosovës është duke u pakësuar.</li> <li>• Akreditimi për trajnim si një pengesë hyrje në tregun e ndërtimit të kapaciteteve në nivelin lokal</li> </ul>
--	---

### 3.3. Potencialet dhe sfidat kryesore

AKK-ja e ka mbajtur qëndrimin e saj si zë i komunave të Kosovës, duke i paraqitur shqetësimet e komunave në qeverinë qendrore dhe në bashkësinë ndërkombëtare, përfshirë donatorët. Ajo po ashtu po e dëshmon veten si fleksibile dhe të përgjegjshme ndaj temave dhe shqetësimeve të reja sa herë që paraqiten ato.

Proceset e brendshme të AKK-së janë duke funksionuar si duhet, me përfshirjen e fuqishme të aktorëve politikë: Kuvendit të AKK-së, Këshillit të Kryetarëve të Komunave dhe Bordit të AKK-së. Krahas kësaj, Kolegjiuemet e AKK-së janë aktive dhe po i bëjnë bashkë aktorët ekzekutiv dhe teknik në komuna për të vendosur për qëndrimet dhe shqetësimet e përbashkëta.

Kjo bazë e fuqishme duhet të ruhet dhe është qenësore për AKK-në. Kjo bazë krijon potencial të konsiderueshëm që AKK-ja të shkojë përpara me punën thelbësore të saj të avokimit për komunat, duke u ofruar shërbime komunave anëtare dhe duke i nxitur zhvillimet në pushtetin lokal.

Marrëdhënie kryesore për AKK-në është ajo me Këshillin e Evropës dhe me Rrjetin e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale në Evropën Juglindore (NALAS). Gjatë periudhës në vijim, Kosova do t'i afrohet Këshillit të Evropës dhe AKK-ja mund ta mbështetë këtë zhvillim dhe ta luajë një rol pozitiv në mbështetjen e përpjekjes për anëtarësim të plotë të Kosovës në Këshillin e Evropës. Një ftesë drejtuar Këshillit të Evropës për ta vlerësuar përparimin e demokracisë lokale do të jetë hap i parë në atë drejtim. AKK-ja tashmë i ka kontribuar raporteve rajonale të NALAS-it, siç është ai për decentralizimin fiskal, ndërsa e ka mundësinë që ta vazhdojë pjesëmarrjen profesionale në të ardhmen.

AKK-ja e merr buxhetin kryesor të saj nga tarifat e anëtarësisë dhe mbështetja institucionale nga SDC-ja. Megjithatë, 'për t'i tejkaluar mundësitë e veta' dhe për të qenë në hap me asociacionet e tjera në rrafshin ndërkombëtar, ajo e shton gamën e aktiviteteve të saj përmes mbështetjes shtesë të donatorëve. Ajo mund të bëjë më shumë falë pozitës unike të saj si organ që e përdor rrjetin e komunave për të bërë avancime përfaqësuese, profesionale



dhe të bazuara në informata të sakta për qytetarë në kuadër të projekteve që financohen nga donatorët. Gama e menjëhershme e këtyre të arriturave mund të prezantohet në planet e punës vjetore, por ajo ka potencial për tu bërë aktor udhëheqës, për aq sa kemi të bëjmë me pushtetin lokal, në tema ta ndryshme siç janë realizimi i caqeve të Kombeve të Bashkuara për zhvillim të qëndrueshëm, zgjerimi i mbledhjes dhe analizimit të Indeksit të Progresit Social, përdorimi i mediave sociale, reagimi ndaj ndryshimeve klimatike dhe krijimi i shërbimit të lajmeve për zbatimin e MSA-së për komunat. Të gjitha këto mund t'i përforcojnë njohuritë dhe profesionalizmin e komunave anëtare dhe të ndihmojnë në ndërtimin e vendit të tyre në thellimin e agjendës evropiane.

Një sfidë e veçantë ekziston në fushën e decentralizimit fiskal. Shumë komuna veprojnë me liri lokale në teori, çfarë bie ndesh me kufizimet historike ndaj strukturës së buxheteve komunale. Pritet që Strategjia e Decentralizimit Fiskal e qeverisë të sjellë ndryshime në financat komunale, por kjo përbën edhe kërcënim, edhe mundësi. AKK-ja ka një rol të fuqishëm për ta luajtur për të dëshmuar se komunat veprojnë me pjekuri dhe kujdes financiar dhe se resurset komunale janë në plan të parë të ofrimit të shërbimeve për qytetarë. AKK-ja po ashtu mund të ofrojë informata për parimet kryesore të praktikës evropiane në decentralizimin financiar.

Studimi i fizibilitetit i vitit 2015 nga SDC mbi Sistemet e Zhvillimit të kapaciteteve për komunat e Kosovës tregon mbivendosjen institucionale dhe boshllëqet në mundësitë e trajnimit për komunat . Ajo gjithashtu e bën të qartë domosdoshmërinë që AKK-ja duhet të luaj një rol aktiv në të gjitha fazat e zhvillimit të kapaciteteve . Nismat për trajnim e kanë potencialin për t'i trajtuar mungesat në trajnim që nuk ofrohen nga aktorët formalë të tjerë. Krahas kësaj, AKK-ja është në ballë të identifikimit të nevojave të komunave për trajnim dhe mund të përgjigjet para aktorëve të tjerë. Trajnimet e kanë një kosto, ndërsa sigurimi i financimit nga komunat dhe donatorët është sfidë. Megjithatë, shërbime të fuqishme dhe efektive komunave mund t'u ofrohen në përgatitjen e projekteve dhe në të kuptuarit e korpusit ligjor të BE-së (Acquis), duke i identifikuar në veçanti pjesët e kapitujve të Acquis që janë relevante për komunat), preferohet përmes një studimi *in situ* të praktikës së shteteve anëtare të BE-së. Akademia Elektronike (e-akademia) e NALAS-it mund të përdoret potencialisht për të forcuar pozitën e AKK-së në ofrimin online të trajnimeve profesionale të specializuara. Ka potencial edhe për të punuar në lëmin e shkollimit terciar, duke u ofruar studentëve praktikë të strukturuar në këmbim të ndonjë studimi hulumtues për politikat e pushtetit lokal në fusha të ndryshme. Trajnimi për anëtarët e zgjedhur të kuvendit komunal mbetet prioritet.

Më në fund, AKK-ja e sheh një sfidë dhe një potencial për ta mbështetur peizazhin e ndryshueshëm të marrëdhënieve komunale, si brenda në Kosovë, ashtu edhe në marrëdhëniet ndërkufitare. Ndonëse disa komuna mund ta shohin një interes për tu marrë me çështjet e përbashkëta bashkërisht, AKK-ja mbetet i vetmi organ i cili mund ta përfaqësojë tërësinë e interesave të komunave në qeverinë e Kosovës dhe në bashkësisë ndërkombëtare.

## 4. Linjat e veprimit strategjik deri në vitin 2020

### 4.1. Vizioni dhe misioni

Vizioni i AKK-së është që të jetë **'në shërbim të komunave për të avancuar demokracinë lokale dhe cilësinë e jetesës për qytetarët e tyre'**

Në vitin 2020, AKK-ja do të jetë më e fuqishme si organizatë dhe më efektive në:

- (1) Avokimin në emër të komunave në nivel qendror, dhe
- (2) Shërbimin për nevojat e komunave anëtare të saj.

Realizimi i vizionit dhe misionit të AKK-së për vitin 2016-2020 do të rezultojë me vazhdimin e fuqizimit të kësaj organizatë, duke e bërë atë unike dhe ekskluzive në aktivitetet e saj në raport me ofrimin e mbrojtjes dhe përfaqësimit të interesave të komunave si dhe ofrimin e shërbimeve sa më cilësore në raport me anëtarët e saj. AKK, është dhe do të vazhdoj të jetë zëri më i besueshëm i komunave në raport me nivelin qendror dhe me instanca tjera përkatëse.

Nëse ky vizion realizohet gjatë viteve të ardhshme, supozohet se qëndrueshmëria financiare e AKK-së do të jetë e sigurt, meqë komunat do ta paguajnë në tërësi anëtarësinë në një organizatë që vazhdon ta dëshmojë dobinë dhe vendosmërinë e saj.

Në këtë drejtim, AKK duke ofruar shërbime të specializuara të një kualiteti të lartë deri në vitin 2020 do të jetë pikë graviteti për të gjitha organizata / agjensionet të cilat veprojnë në fushën e pushtetit lokal. Si mekanizëm i vetëm që përfaqëson pushtetin lokal në Kosovë do të jetë edhe një lider në ofrimin e shërbimeve edhe për vetë komunat.

Së bashku me partnerët e tjerë do të ofroj trajnime moderne me qëllim të avancimit të çështjes së cilësisë së jetesës për qytetarët në komuna.

Gjithashtu duke i'u përshtatur ndryshimeve aktuale në raport me hapat e Kosovës, respektivisht komunave drejt anëtarësimit në BE, AKK do të luaj rolin e promotorit të zhvillimit ekonomik lokal përmes promovimit të shtegut drejt një qeverisje të mirë, prosperuese me integritet dhe që siguron zhvillim.

### 4.2. Linjat e veprimit

Linjat kryesore të planit strategjik të AKK-së janë:

1. Avokimi dhe lobimi proaktiv
2. Ngritja efektive e kapaciteteve
3. Ofrimi i shërbimeve të përmirësuara
4. Efikasiteti organizativ

### **4.3. Avokimi dhe lobimi proaktiv**

#### **Rezultat e pritura**

- Interesat e komunave promovohen dhe mbrohen me qeverinë qendrore, agjencitë ndërkombëtare dhe institucionet e tjera relevante.
- Aktivitetet e komunave për lobim bashkërendohen në mënyrë efektive për t'ua mundësuar atyre që të flasin me një zë
- Legjislacioni kombëtar që ndikon në komuna harmonizohet dhe u shërben nevojave të tyre.

#### **Rezultatet që duhet të arrihen:**

1. Sigurimi i një gjendje të harmonizuar dhe ligjërisht të qartë sa i përket zbatimit të Ligjeve që mbulojnë fushën e qeverisjes lokale
2. Decentralizim relevant fiskal, i cili promovon zhvillim për komunat
3. Identifikimi i çështjeve aktuale dhe përgatitja me kohë i qëndrimeve analitike dhe strategjike
4. Konsolidimi dhe negociimi i qëndrimeve me organet e nivelit qendror (ZKM-në, komisionet parlamentare, grupet punuese ministrore)
5. Adresimi dhe komunikimi me efektivitet i politikave të AKK tek qeveria dhe publiku.

#### **Sferat me prioritet**

Janë identifikuar sferat prioritare me rëndësi për qeveritë lokale dhe ku AKK me anë të lobimit mund të fuqizoj rolin e Komunave si vijim:

- Shërbimet komunale, përmirësimi i cilësisë së shërbimeve aktuale dhe krijimi i shërbimeve të reja duke përfshirë shërbimet elektronike.
- Arsim dhe shëndetësi elektronike.
- Financat komunale, - heqja e kufizimit për kategoritë ekonomike dhe definimi i kriterëve për grantet specifike.
- Sistemi fiskal: rritje të të hyrave vetanake pa prekur grantin e përgjithshëm qeveritar për komunat.
- Zhvillimi ekonomik lokal: promovimi i ekonomisë së gjelbër, zhvillimi i turizmit kulturor, mjedis i favorshëm i zhvillimit të NVM, fondet të shtuara nga BE, menaxhimi i pronës komunale, eficienta e energjisë.
- Promovimin e barazisë gjinore në nivelin lokal.

AKK në baza vjetore do të përgatis planin e veprimit për prioritetet e lartëcekura.


Krahas kësaj, AKK-ja do t'ua kushtojë vëmendje zhvillimeve të tjera të rëndësishme, të cilat mund të ndikojnë në avancimin e qeverisë lokale.

## Mekanizimi për avokim dhe lobim

Proaktiviteti i AKK-së do të jetë i vazhdueshëm si në marrjen e qëndrimeve politike ashtu transmetimit të tyre, në mënyrë që t'u shpërbejë interesave të anëtarëve të saj. Në diagramin e mëposhtëm është ofruar një ilustrim i hapave kryesorë proceseve të tilla.

### Cikli i procesit të lobimit tek institucionet qendrore:

Caktimi i prioriteteve/ agjendës dhe rruga e mënyra lobimit



Në shtojcën 1. janë ofruar më shumë hollësi për procesin e avokimit dhe lobimit. Aty është bërë një dallim midis asaj që quhet **proces standard** (kur koha e mjaftueshme mundëson shtjellimin e hollësishëm të politikave) dhe **avokimin ad-hoc** (kur çështje emergjente paraqiten me njoftim të shpejtë dhe për të cilat lipset reagimi i menjëhershëm i kësaj organizate).

#### **4.4. Ngritja efektive e kapaciteteve**

##### **Rezultatet e pritura**

- Zyrtarët e zgjedhur dhe të emëruar politikisht kanë qasje në trajnime të cilësisë së lartë për t'u ndihmuar në detyrat e tyre si përfaqësues të qytetarëve dhe si udhëheqës komunalë.
- AKK-ja e krijon pozitën e saj si ofrues i respektuar i trajnimeve për pushtetit lokal.
- AKK-ja i përkrah komunat në përcaktimin e programeve të veta të trajnimit dhe në sigurimin e niveleve të përshtatshme të shpenzimeve operative (si përqindje e pagës) për t'i mbështetur ato programe.

##### **Rezultatet që duhet të arrihen:**

1. Përmbajtja e përmirësuar e trajnimeve e përshtatshme për kryetarët dhe zëvendës-kryetarët e komunave, deputetët e kuvendeve komunale dhe drejtorët e emëruar.
2. Realizimi i programeve vjetore të trajnimit për zyrtarët e zgjedhur dhe të emëruar politikisht, me theks të veçantë në vitin zgjedhor dhe paszgjedhor.
3. Njohja publike e AKK-së si një institut i trajnimit për pushtetin lokal (me licencim sipas nevojës).
4. Avokimi i suksesshëm për trajnime në pronësi të komunave, të prioretizuara dhe të financuara për zyrtarët e pushtetit lokal.
5. Fillimi i angazhimit të universiteteve dhe studentëve në hulumtime për administratën e pushtetit lokal që për cak kanë nevojat specifike të komunave.
6. Zhvillimi i rolit të AKK-së si katalizatorë e trajnimit për komunat, përfshirë trajnimet dhe shërbimet inovative të financuara nga donatorët.

##### **Diskutimi i prioriteteve**

Gjatë periudhës së strategjisë së mëparshme, AKK-ja është përpjekur që t'i trajtojë mungesat në trajnim për komunat në të gjitha nivelet, por ka qenë vetëm pjesërisht e suksesshme. Ajo po ashtu ka vërejtur dobësi në përpjekjet e qeverisë qendrore për t'i zbatuar strategjitë e kamotshme për reformimin e administratës publike dhe për t'i çuar përpara zotimet për trajnim për komunat.

Strategjia e re e parasheh një përkushtim të shtuar ndaj qëllimit të AKK-së për të organizuar dhe bashkërenduar trajnime profesionale për përfaqësuesit politikë dhe shërbyesit civilë, siç është autorizuar edhe me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale.

AKK-ja e pranon se trajnimi i qëndrueshëm afatgjatë varet nga pranimi i rëndësisë së trajnimit nga vetë komunat dhe nga një bazë ekonomike e re për trajnim që e inkurajon përdorimin e një pjese të listës komunale të pagesave për qëllime të trajnimit. Financimi i

trajnimin është një fushë tjetër ku komunat duhet të jenë të lira që ta përcaktojnë strukturën ekonomike të buxheteve të tyre<sup>1</sup>.

Si fazë e parë e ndërtimit efektiv të kapaciteteve, AKK-ja do të kërkojë ndihmë nga donatorët për hartimin e materialeve për trajnim (kosto fikse e lartë), përderisa do të kërkojë mbështetje financiare të bazuar në tarifa nga komunat për realizimin operativ të trajnimit.

AKK-ja po ashtu ka një rol kritik për ta luajtur në kërkimin e bashkërendimit midis qeverisë dhe donatorëve përkitazi me nevojat për trajnim të vetë AKK-së dhe komunave. AKK-ja do të përpiqet që të jetë 'zëri i arsyes' për t'i mbajtur të gjithë aktorët të përqendruar në rëndësinë jetike të zhvillimit të një sistemi gjithëpërfshirës të trajnimit të institucionalizuar, siç kërkohet për organe komunale profesionale, evropiane.

Vëmendje i kushtohet edhe faktit se disiplinat e pushtetit lokal do të bëhen gjithnjë e më teknike përderisa Kosova zhvillohet. Në strategji parashihet që trajnimi i përgjithshëm të zëvendësohet gradualisht me trajnim më specifik dhe më teknik që ka të bëjë me kushtet e përafrimit në Bashkimin Evropian.

#### **4.5. Ofrimi i shërbimeve më të mira**

##### **Rezultatet e pritura**

- Funksionimi i brendshëm efikas i administratave komunale mbështetet përmes strategjive të integruara dhe strukturave të organizimit që u shërbejnë qytetarëve dhe sektorit privat.
- Një përqendrim i ri në vlerësimin e rezultateve për qytetarë të ndikuara nga pushteti lokal i cilësisë së lartë.
- Një ngritje në cilësinë e paraqitjes të prioriteteve komunale tek burimet e financimit nga palët e treta (donatorët dhe institucionet financuese) me synimin për ta përmirësuar cilësinë e infrastrukturës dhe resurseve publike.

##### **Rezultatet që duhet të arrihen**

1. Kolegjiumet e AKK-së janë në gjendje që t'i harmonizojnë strategjitë, aktet dhe strukturat organizative në një mënyrë që e mbështet një pamje të operacioneve komunale të artikuluar qartë si në nivel kombëtar, ashtu edhe në nivel komunal.
2. Kolegjiumeve u ofrohet mbështetje e duhur për ta shtuar efikasitetin dhe kontributin strategjik të tyre.
3. Komunat përgatisin gjithnjë e më shumë plane strategjike dhe të integruara që 'janë botën reale' dhe që ua japin qytetarëve, donatorëve dhe qeverisë një pasqyrë koncize dhe të qartë të rezultateve të synuara si dhe veprimeve e resurseve të tyre për t'i arritur ato rezultate.

---

<sup>1</sup> Kjo qasje është ekuivalente me opsionin 3 në "Studimin e Fizibilitetit për Sistemin e Ngritjes së Kapaciteteve për Komunat në Kosovë" të përgatitur nga DEMOS-i në Nëntor të vitit 2015.

---

4. AKK-ja ofron mbështetje për krijimin e sistemeve të performancës së shërbimeve publike që janë të harmonizuara me praktikën ndërkombëtare dhe që e demonstrojnë përparimin që e bën Kosova në kuadër të progresit social; roli i pushtetit lokal është i siguruar në sistemet e tilla
5. Komunave u ofrohet asistencë për t'i shtuar burimet vetanake të tyre, veçanërisht përmes sigurimit dhe zhvillimit të ekspertizës për t'i prezantuar nevojat e komunave për financim nga palët e treta
6. AKK-ja përgatit materiale këshillëdhënëse për komunat lidhur me përdorimin e financimit të borxheve për projektet komunale kapitale
7. AKK-ja zhvillon studime të fizibilitetit për modelet inovative të ofrimit të shërbimeve, veçanërisht për komunat e vogla, duke e marrë parasysh AKK-në si ofrues të shërbimeve, bashkëpunimin ndërkomunal dhe bashkëpunimin ndërkufitar

## Diskutimi i prioriteteve

Roli i AKK-së nuk është që të krijojë apo përcaktojë garë midis komunave të ndryshme, por që t'i mbështetë të gjitha komunat në sferat e interesit të përbashkët. Megjithatë, ajo e pranon se disa komuna do të zhvillojnë sfera të veçanta të ekspertizës ku ato mund të shihen si 'lidere' apo 'inovatore'. AKK-ja do të përpiqet që t'i shfrytëzojë këto përparësi përmes kolegjiemeve të AKK-së, në mënyrë që e tërë Kosova të përfitojë nga orientimet dhe shembujt pozitivë të rinj.

AKK-ja po ashtu vëren se ndërhyrjet e donatorëve mund të krijojnë shtrembërime në zhvillimin e komunave, ose duke i shtyrë disa komuna përpara (duke i lënë të tjerat prapa, siç nënkuptohet), ose duke e vënë në përdorim në administratat komunale ndonjë 'produkt' që nuk mund të përdoret përsëri në vitet e ardhshme. Në këtë kontekst, AKK-ja pranon se ka nevojë që planifikimi strategjik i komunave të sistemohet në dokumente relativisht të thjeshta për t'i treguar publikut, donatorit dhe qeverisë se cilat janë prioritetet kryesore. Kjo do të ndihmojë në largimin e mjegullës sa i përket planifikimit komunal.

Kolegjiemet e AKK-së janë organet kryesore për bashkërendim komunal dhe inovacion. Parashihet se në periudhën në vijim kolegjiemet mund të bëhen gjithnjë e më të rëndësishme në aspektin strategjik, duke ofruar analiza të hollësishme dhe profesionale për nevojat dhe mundësitë e komunave dhe si mekanizëm për paraqitjen e zhvillimeve. AKK-ja do të kërkojë ndihmë shtesë për kolegjiemet për t'i stimuluar komunat anëtare të saj dhe për ta shtuar rëndësinë e takimeve të tyre.

Caqet e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Qëndrueshëm (CZhQ-të) i kanë dhënë shtysë ndërkombëtare të gjitha vendeve që kanë kërkuar rezultate për popujt e tyre. CZhQ-të nuk i kanë për cak vetëm vendet me shkallë të ulët të zhvillimit ekonomik, por të gjitha vendet, me shkallë ose të lartë ose të mesme të zhvillimit ekonomik, siç është Kosova. Me CZhQ-të ndërlidhen nisma siç është ajo e Indeksit të Progresit Social<sup>2</sup>. AKK-ja e pranon se komunat, si linjë frontale e pushtetit, kanë rëndësi të veçantë për vlerësimin e shërbimeve për qytetarë dhe, për këtë arsye, kërkon një rol kyç në shtyrjen përpara të nismave të tilla. Hapi i parë është që të sigurohet që Kosova të përfaqësohet drejt në krahasuesit ndërkombëtarë.

---

<sup>2</sup> Shih <http://www.socialprogressimperative.org>

AKK-ja po ashtu e ka një rol si ndërfaqe midis donatorëve dhe institucioneve financuese për t'u ndihmuar komunave që t'i përgatisin projektet prioritare të tyre në detaje të duhura dhe në përputhje me kushtet e palës së tretë. Në periudhën në vijim, kjo mbështetje për komunat duhet të zgjerohet për ta përfshirë edhe qasjen në financim të borxheve dhe menaxhim të tyre.

Efikasiteti dhe inovacionet janë aspekt i rëndësishëm i zhvillimit komunal në kontekst të kufizimeve në burime. Komunat e vogla dhe shumë të vogla shihen si komuna që e kanë veçanërisht të vështirë që ta ofrojnë tërë gamën e shërbimeve të pushtetit lokal. AKK-ja do të udhëheqë në identifikimin e mekanizmave dhe strategjive që u ndihmojnë komunave që shërbimet e tyre t'i ofrojnë me kosto më të ulët, për shembull përmes bashkëpunimit ndërkomunal apo përmes vetë AKK-së, e cila do të ofrojë shërbime profesionale të specializuara me orar të shkurtuar dhe shpenzime të ndara (shërbimet peripatetike).

#### **4.6. Efikasiteti organizativ**

##### **Rezultatet e pritura**

- AKK-ja është organizatë kompetente, përparimtare dhe financiarisht e qëndrueshme në vitin 2020, me ndikim substancial në procesin e decentralizimit.
- Bordi i AKK-së dhe Këshilli i Kryetarëve të Komunave ofrojnë udhëzime politike dhe strategjike.
- AKK-ja, kryesisht përmes "Miq të AKK-së", i ruan marrëdhëniet e shkëlqyera me komunitetin e donatorëve ndërkombëtar.

##### **Rezultatet që duhet të arrihen**

1. AKK-ja i përmbush obligimet statutores të saj sipas statutit dhe udhëzimeve operative.
  2. AKK-ja e arrin mbledhjen e tarifave të anëtarësisë në shkallë prej 100%.
  3. AKK-ja e përmirëson bashkëveprimin midis organeve të Asociacionit.
  4. AKK-ja me sukses vazhdon të aplikojë për projekte të financuara të donatorët dhe t'i realizojë ato.
  5. AKK-ja u përmbahet të gjitha kërkesave që kanë të bëjnë me planifikimin vjetor dhe ciklin e raportimit.
  6. Kjo organizatë menaxhohet në mënyrë efikase nga Drejtori Ekzekutiv dhe stafi, sipas planeve dhe buxheteve vjetore të aprovuara.
-



## 5. Partneritetet dhe marrëdhëniet e jashtme

Me qëllim të kanalizimit sa më efikas të interesave të komunave tek akterët e synuar, AKK krijon ura bashkëpunimi me partnerët dhe donatorët e ndryshëm, edhe për të ofruar shërbime për anëtarët e tij edhe përmes projekteve të caktuara.

### ‘Miqtë e AKK-së’

AKK ka krijuar tashmë mekanizmin e quajtur “Miqtë e AKK-së” për të bashkërenduar dhe përshtatur mbështetjen e donatorëve për komunat në Kosovë. Ky mekanizëm sjell së bashku donatorët dy- apo me shumë-palësh në projekte aktive në mbështetjen qeverinë lokale në nivel vendi. “Miqtë e AKK-së” informohen rregullisht për planifikimin e aktiviteteve vjetore dhe për ciklin e raportimit dhe do të kërkohet mbështetja e tyre për aktivitete specifike.

### Rjetet Regjionale dhe Evropiane

Në një të ardhme afatmesme, integrimi regjional dhe evropian pritet të ketë rritje. Për këtë qëllim, AKK-ja duhet të marr pjesë aktivisht në rrjetet dhe organet përkatëse me synimin për zgjerimin e tyre në vazhdimësi.

AKK-ja do të vazhdojë të mbajë dhe të zgjeroj, marrëdhëniet e saja ekzistuese me organizatat regjionale dhe evropiane. Këto aktualisht përfshijnë:

- Kongresi i Qeverive Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës
- Komiteti i Evropian i Komunave dhe Regjioneve

Në të dy organizatat, AKK-ja ka për qëllim të ngrit statusin e tanishëm të vëzhguesit ose të ftuarit në anëtarë të plotë.

Poashtu AKK-ja është tashmë një anëtar i plotë në:

- NALAS (Rrjeti i Autoriteteve Lokale të Evropë Jug-Lindore);
- ALDA (Asociacioni i Agjensive për Demokraci Lokale).

Objektivat strategjike specifike për këto partneritete janë të shumëfishtë: AKK-ja mund të hyj në ekspertizë të kualifikuar dhe të marr pjesë në grupet punuese për çështje thelbësore të lidhura me qeverinë lokale dhe qeverisjen, pjesëmarrja aktive e qytetarëve, mbrojtja e të drejtave të njeriut, fuqizimi i shoqërisë civile, etj. Informacionet do të jenë në dispozicion në Programet e BE, fondet dhe procedurat dhe mundësitë e partneritetit për projekte të përbashkëta të tenderimit. Për më tepër, ai ua mundëson AKK-së për të marrë pjesë në aktivitetet ndërkombëtare, promovuar nga organizata e mësipërme dhe rrjetet. Njëkohësisht, përmes këtyre kanaleve AKK-ja mund të prezantoj dhe promovoj arritjet e autoriteteve lokale në Kosovë dhe rritjen e vizibilitetit të vendit dhe të organizatës në rajon dhe Evropë.

## 6. Burimet dhe financimi

Financimi i AKK-së është i bazuar në tri burime kryesore:

1. **Të hyrat vetanake** (Parapagesat e anëtarësisë nga Komunat)
2. **Të hyrat nga palët e treta** (grantet e ndryshme prej institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare të cilat janë partnere të AKK-së).
3. **Të hyrat të tjera** (shërbimet e ofruara më pagesë e cila mbetet si projeksion për të ardhmen)

**Të hyrat vetanake** - Gjatë pesë viteve të kaluara, AKK ka arritur që të krijoj një qëndrueshmëri solide financiare e cila ka rezultuar më një ngritje të ndjeshme të të hyrave vetanake të cilat janë të bazuara në parapagesat e anëtarësisë së komunave. Ky trend pozitiv në të hyrat vetanake ka ardhur si rezultat i punës dhe shërbimeve të avancuara të ofruara nga AKK në raport me anëtarët e saj. Në këtë kontekst, AKK ka arritur që të krijoj një kulturë kontraktuale, por edhe mirëbesimi në raport me komunat e cila nënkupton ofrimin e shërbimeve sa më cilësore dhe në anën tjetër gatishmërinë e komunave për të marrë pjesë në buxhetin e AKK-së. Kjo dëshkohet më së miri në hulumtimet vjetore që janë porositur nga Organizata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) dhe të cilat janë realizuara me kryetarë të Komunave, por edhe me zyrtarë të tjerë nga administratat komunale për të matur kënaqshmerinë e komunave në raport me AKK-në. Rezultat e këtyre hulumtimeve kanë qenë jashtëzakonisht inkurajuese për AKK-në.

Qëllimi kryesor i AKK-së është që gjatë 5 viteve të ardhshme të punoj strategjikisht me komunat për të forcuar kulturën institucionaliste në kryerjen e obligimeve nga ana e tyre në raport më pagesën e anëtarësisë duke synuar mbledhjen e tarifave të anëtarësisë në nivelin maksimal. AKK përmes mekanizmave të saj do të synoj që çështja e pagesës së anëtarësisë të jetë pjesë e projekteve buxhetore të komunave si në planin afat mesëm, ashtu edhe në planin afatgjatë. Një pjesë e konsiderueshme e komunave tanimë kanë futur pagesën e anëtarësisë në planet e tyre buxhetore.

Pritjet e AKK-së janë që si çak i mbledhjes së anëtarësisë në vitin 2016 të jetë shuma 140,000 €, duke synuar rritje të vazhdueshme deri në vitin 2020.

**Të hyrat nga palët e treta** – Pavarësisht trendit pozitiv në të hyrat vetanake, AKK vazhdon të jetë e varur edhe nga financimi nga grantet dhe mbështetja financiare e ofruara nga organizata të ndryshme ndërkombëtare. Një ndër shtyllat kryesore të këtij financimi crucial për AKK-në ka qenë Agjencioni për Zhvillim dhe bashkëpunim Zvicërian (SDC) e cila ka ofruar një mbështetje të fuqishme jo vetëm për AKK-në, por në të njëjtën kohë edhe për komunat e Kosovës në përgjithësi. Kjo mbështetje financiare e AKK-së ka bërë që AKK jo vetëm të realizoj objektivat e saj strategjike të cilat kanë qenë pjesë e Strategjisë së AKK-së 2011-2015 por edhe t'i tejkaloj ato. Ky bashkëpunim është vlerësuar si shumë efektiv nga vet SDC e cila ka vazhduar mbështetjen financiare të AKK-së deri në vitin 2017.

Përveç SDC-së si një nga partnerët kryesor në ofrimin mbështetjes financiare, AKK ka pasur dhe vazhdon ta ketë si qëllim strategjik bashkëpunimin dhe kërkimin e fondeve edhe nga organizata dhe partnerë të tjerë vendor dhe ndërkombëtarë. Në këtë kontekst, AKK synon që gjatë nxjerrjes së planeve vjetore aksionale që janë derivat i kësaj strategjie të përfshihet edhe kostoja financiare e aktiviteteve që janë të parapara në kuadër të objektivave të

caktuara dhe të njëjtat të diskutohen me partnerë në kuadër të konferencës vjetore “Miq të e AKK-së” në mënyrë që të kërkohet financimi i aktiviteteve që janë në kuadër të objektivave të përbashkëta.

**Të hyrat të tjera** – të hyrat nënkuptojnë konceptin e të hyrave të cilat vijnë si rezultat i ofrimit të shërbimeve me pagesë nga AKK. Gjatë këtyre pesë viteve të ardhshme do të punohet në projektimin e këtyre të hyrave duke testuar gatishmërinë e komunave si anëtare të AKK-së, por edhe palëve tjera të interesuar për blerjen e produkteve të ofruara nga AKK. Këto produkte do të fokusohen kryesisht në ofrimin e trajnimeve, pastaj në ofrimin e ekspertizës dhe konsultave profesionale dhe produkteve tjera të cilat do të konceptohen në proces.

## 7. Planifikimi, monitorimi dhe raportimi

Një nga çështjet prioritare të AKK-së ka të bëjë me planifikimin, monitorimin dhe raportimin e aktiviteteve të cilat janë të parapara në Planin Strategjik afat gjatë të AKK-së si dhe në planet vjetore.

- AKK zhvillon finalizon me kohe Planin Strategjik Afatgjatë (5 vjeçar)
- AKK zhvillon dhe finalizon me kohe Planin Vjetor të Veprimit
- AKK zhvillon dhe finalizon me Planin Buxhetor të organizatës i cili miratohet nga Bordi dhe Kuvendi i AKK-së.
- AKK monitoron dhe mat rezultatet konkrete të realizimit të Planit Vjetor të Veprimit përmes indikatorëve dhe mjeteve të verifikimit.
- Monitorimi i rezultateve bëhet përmes raporteve periodike të progresit (vjetore dhe gjysmëvjetore)
- AKK bën raporte të rregullta financiare të cilat miratohen nga Bordi i AKK-së dhe Kuvendi i Përgjithshëm.
- AKK i nënshtrohet një auditimi të pavarur të pasqyrave financiare vjetore (Kompani ndërkombëtare të auditimit).

## 8. Komunikimi dhe PR

Raporti me anëtarët dhe partnerët kërkon komunikim të avancuar. AKK-ja është në njohuri për rëndësinë e komunikimit aktiv, sidomos për komunikimin në varësi edhe të ndryshimeve dhe zhvillimeve teknologjike. Pastaj për komunikimin për aktivitetet me anëtarët partnerët dhe audiencën tjetër. Për këtë qëllim do të vazhdohet të ndiqet një politikë parimore e komunikimit të hapur dhe transparent.

Komunat janë të informuara në kohë (në baza ditore) dhe me saktësi mbi zhvillimet relevante në nivel qendror, derisa organeve të nivelit qendror duhet t'u komunikohen e transmetohen qartë qëndrimet dhe shqetësimet e qeverive lokale.

Komunikimi i brendshëm si një mjet i arritjes të sukseseve duhet të sigurohet në mes organeve të ndryshme të AKK-së, pra Kuvendit të Përgjithshëm, Bordit dhe Këshillit, si dhe Zyrës Ekzekutive.


Mediat janë kanalet të rëndësishme për informimin e publikut të gjerë me informata relevante lidhur me çështjet e qeverisjes lokale dhe procesin e decentralizimit në përgjithësi, sukseset e arritura si dhe pengesa të hasura në këtë proces. Komunikimi me mediat bëhet në mënyrë që të stimulojë një diskutim publik për çështjet e ngritura në qeverisjen lokale.

Komunikimi i hapur dhe transparent i AKK-së në interes të komunave të Kosovës përfshin edhe komunitetin e partnerëve vendor e ndërkombëtar në veçanti organizatat ndërkombëtare ku AKK është e anëtarësuar.

Aktualisht, mjetet kryesore të komunikimit të AKK-së janë informatat në formë shkresave, Buletini i AKK-së (botuar rregullisht në shqip, serbisht dhe anglisht), faqja e internetit e AKK-së, rrjetet sociale, broshura ose manuale me tema specifike, si dhe raporte standarde të progresit.

## Shtojca 1: Proceset e avokimit dhe lobimit

### Lobimi standard / procesi i avokimit



### Avokimi / Lobimi urgjent / ad hoc

